

VENDIM
Nr.965, datë 2.7.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, (objekte, pjesa e dytë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me vlerë të përgjithshme 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 515 000 (pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë “Fondi i shpronësimeve” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.6.2008 dhe të përfundojë më 30.9.2008.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe hartave përkatëse, që do t’i vihen në dispozicion nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE, PASURITË (OBJEKTE) NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
RRËSHEN-KALIMASH

Nr	Emri	Pronari		Nr. Pasurisë	Vlera lekë	Fshati	Shënime
		Atësia	Mbiemri				
1.	Preng	Gjon	Marpepa	173	1939220	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
2.	Ndue	Nikoll	Ndoj	200	4172486	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
3.	Ardian	Fran	Prenga	143	462661	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
4.	Ndue	Frrok	Marku	170	2261755	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
5.	Agustin	Zef	Marku	43/1	2054356	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
6.	Pashk	Ded	Nikolli	59/7	1783282	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
7.	Gëzim	Mark	Gjoka	81/11	1803086	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
8.	Rrok	Gjet	Gjergji		1240632	Zall-Xhuxh	Proces regjistrimi
9.	Martin	Ndue	Gjeta	30	2197050	Zall-Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
10.	Zef	Llesh	Mena	206	2929735	Zall-Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
11.	Zef	Ndue	Karaci	193	2588396	Zall-Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
12.	Shkëlzen	Ded	Prendi	88/2	418025	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
13.	Mëhill	Kol	Gjoka	112/4	1510837	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
14.	Ndue	Mëhill	Gjoka	112/5	2432437	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
15.	Paulin	Ded	Prendi	88/5	397917	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
16.	Nikoll	Ndue	Gjergji		1880330	Sang	Proces Regjistrimi
17.	Ded	Ndue	Ndoj	161	1837939	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
18.	Ndue	Preng	Prenga		1216783	Sang	Proces Regjistrimi
19.	Gjok	Ndue	Ndoj	162	2091319	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
20.	Gjergj	Zef	Ndreca	69/3	1546731	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
21.	Cup	Nikoll	Boci		1426955	Klos	Proces Regjistrimi
22.	Kol	Ndue	Lleshi	88/6	3493059	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
23.	Dava	Nikoll	Tuci	84/5	2021959	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
24.	Pashk	Frrok	Nikolli	144/1	1313121	Geziq	Konfirmuar nga ZRPP
25.	Gjet	Nikoll	Pershqefa	60	2395460	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali			47415531		

